

VENDIM
Nr. 693, datë 10.10.2012

**PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, QË LËSHOHET NË FAVOR TË
RAIFFEISEN BANK SHA, ALBANIA DHE INTESA SANPAOLO SHA, ALBANIA, NË
KUADËR TË KONTRATAVE PËRKATËSE NDËRMJET KËTYRE BANKAVE DHE KESH
SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar dhe të nenit 3 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë qeveritare, që lëshohet në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huas ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a., për shumën ekuivalente, në lekë, të shumës 40 (dyzet) milionë euro.

2. Miratimin e garancisë qeveritare, që lëshohet në favor të Intesa Sanpaolo sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huas ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a., për shumën 1 400 000 000 (një miliard e katërqind milionë) lekë.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha